



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “ BEQIR ÇELA “ DURRËS

Nr. 68 Prot

Durrës , më 26.02.2021

**Lenda:** Njoftim për vende të lira pune  
Sektorit të burimeve njerezore  
Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse

**Drejtuar:** AGJENSISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
TIRANË

Bazuar në ligjin nr 15 datë 16.02.2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë , vendimit të këshillit të ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjensisë Kombëtare të punësimit dhe Aftësive në Udhëzimin nr 11 datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional si dhe në udhëzimin nr 28 date 14.10.2019 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit profesional “(fletore zyrtare 2020 –numri 12 ) , ju njoftojmë për kandidatet që kualifikohen vendin vakant për pozicionet e mëposhtme:

1-Mësimdhënës të praktikës profesionale në drejtimin Shërbime Mjetesh Transporti- 1(nje) mesues

**Liljana Çyrbja**

**Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit të AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:**

**1. Kritere të përgjithshme:**

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

**2. Kriteria të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim të mesëm profesional:**

- a) të ketë diplomë nga një institucion i arsimit të lartët të nivelit master i profesionit ose master i shkencave ose të barasvlershme, për një nga profilet që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së.
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet.
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

**3. Kriteria të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional:**

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose të nivelit bachelor në një nga profilet, që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

#### **Dokumentet e aplikimit**

1. Dosja e aplikimit, e cila permban dokumentacionin e kerkuar sipas njoftimit të vendit të lië, duhet të përfshijë:

- a) Letër motivimi për pozicionin;
- b) Jetëshkrim (CV-në), I cili plotësohet sipas formatit *Europass* në shtojcën 1, të këtij udhëzimi;
- c) Të dhënat e aplikuesit, të plotësuara sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2, të këtij udhëzimi;
- d) Fotokopje të kartës së identitetit, fotokopje të diplomës dhe fotokopje të librezës së punës;
- e) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- f) Certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- i) Vërtetim nga punëdhënësit e mëparshëm, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- j) Të paktën një rekomndim ose vlerësim pune nga punëdhënësit të mëparshëm.

**Shenim: Per vendin vakant u paraqit vetem nje kandidat znj.Liljana Çyrbja.**

**Ju faleminderit !**

**DREJTOR**  
**Fatmir MERKURI**

